

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Teuta Krusha me pjesëmarrjen e sekretares juridike Myrvete Përdibuka procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit Gj. V. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm nën numrin PP/II.nr.1370/2015 të datës 02.09.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në praninë e prokurorit të shtetit Mehreme Hoxha dhe të akuzuarit, me datë 28.12.2017 publikisht morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

GJ. V. nga i ati R. dhe e ëma F. e lindur B., i lindur më datë *data e lindjes...* në Prizren, ku edhe tani jeton rruga ... pa nr., pa shkollë – nuk din shkrim lexim, punëtor krahu, i martuar, baba i një fëmije, me numër personal *numri personal...*, rom, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfër ekonomike.

PËR SHKAK

Në muajin nëntor të vitit 2014, në Prizren në ..., blen sendin për të cilin ka mundur të dijë se është përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga personat e panjohur, blen telefonin celular të markës “Samsung S2”, pronë e dëmtuarit A. K., për të cilin telefon në emër të çmimit ka paguar 50 €.

Kësodore ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK.

Gjykata në kuptim të dispozitave të nenit 7, 85, 86, 73 dhe nenit 345 par.2 të KPK i shqipton:

VËREJTJE GJYQSORE

I akuzuari **Gj. V.** pasi që ka kryer veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK, vepër penale e cila është e rrezikshme dhe e dëmshme, i njëjti nëse sërish kryen vepra të tilla do të dënohet me dënim më të rëndë.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.1370/2015 të datës 02.09.2016, kundër të akuzuarit Gj. V. nga Prizreni, për shkak të veprës penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2 të KPK.

Gjykata në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit, i shpalosi dhe bëri prezantimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit, i njëjti u deklarua se ka kuptuar aktakuzën, nuk e kundërshton provat materiale dhe e ndjen veten fajtor për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Në muajin nëntor të vitit 2014, në Prizren në tregun e automjeteve ku shiten edhe gjësende tjera, i akuzuari Gj. V. blen telefonin celular të markës “Samsung S2”, i cili telefon ishte përfituar me kryerjen e veprës penale, në atë mënyrë që nga personat e panjohur blen telefonin dhe në emër të çmimit paguan 50 €, i cili është pronë e dëmtuarit A. K..

Gjykata gjendjen e këtillë faktike ka vërtetuar nga pranimi vullnetar i fajësisë nga ana e akuzuarit për veprimet e përshkruara si në përshkrimin faktik të aktakuzës. Gjykata ka analizuar aktakuzën dhe provat në të cilat mbështetet aktakuza dhe ka ardhur në përfundim nuk ka prova të papranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale me të cilën ngarkohet dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht. Vlen të theksohet se pranimi i fajit është mbështetur në fakte që përmban aktakuza, me ç'rast i akuzuari në shqyrtimin fillestar nuk i ka kundërshtuar. Po ashtu gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 246 të KPPK dhe në veprimet e tij formohen të gjitha elementet e qenësore të veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i morri parasysh të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPK, të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, pasi që nuk ka gjetur asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese morri parasysh faktin se ka pranuar fajësinë dhe ka tregu bashkëpunim me organet e drejtësisë, sjellja korrekte gjatë zhvillimit të procedurës, është i gjendjes së varfë ekonomike, është kryefamiljar dhe mbajtës i vetëm i familjes, pendimi për kryerjen e veprës penale, gjer më tani nuk ka kryer vepër penale, andaj gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat lidhur me kryesin dhe veprën e kryer i shqiptoi vërejtje gjyqësore, sepse konsideron se me qortim do të arrihet qëllimi i sanksioni, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë do të arrihet qëllimi i qortimit që në të ardhmen të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 453 par.1 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
P.nr.1871/2016 të datës 28.12.2017

Procesmbajtësja
Myrvete Përdibuka

Gjyqtarja
Teuta Krusha

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.